

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve sh.a

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	
Pasqyra e pozitës financiare	1
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	3
Pasqyra e rrjedhës së parasë	4
Shënimet për pasqyrat financiare	5-29

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR*

Për Menaxhmentin dhe Aksionarët e Fondit Sllloveno Kosovar të Pensioneve Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjëlëse të Fondit Sllloveno Kosovar të Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si "Shoqëria") që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrës e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, dhe një përmbledhje të politikave kryesore kontabël dhe shënimeve tjera sqaruese.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti vendos se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit


Përgjegjësia jonë është të shprehim opinionin për këto pasqyrat financiare në bazë të auditimit tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Ato standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe që të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të fituar siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të shoqërisë për të dizajnuar procedurat e auditimit që janë të duhura në ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël që përdoren dhe arsyeshmërisë së vlersimeve të kontabilitetit të kryera nga menaxhmenti, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të dhënë bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2015, të performancës së saj financiare, dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
29 mars 2016

* Ky raport është përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojnë versioni në gjuhën angleze.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SH.A


PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

më 31 dhjetor 2015

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2015	(Në Euro) Më 31 dhjetor 2014
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	36,075	47,800
Investime të mbajtura deri në maturim	6	344,438	301,005
Investimet në dispozicion për shitje	7	24,662	24,452
Prona dhe pajisjet	8	11,142	16,104
Pasuritë e patrupëzuara	9	1,800	6,000
Pasuritë tjera	10	53,506	42,816
Gjithsej pasuritë		471,623	438,177
Detyrimet			
Detyrimet tregtare dhe tjera	11	15,358	6,131
Detyrimet e lizingut financiar	12	9,476	11,949
		24,834	18,080
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	13	400,000	400,000
Rezerva e rivlerësuar për letrat me vlerë		546	335
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		46,243	19,762
		446,789	420,097
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		471,623	438,177

Këto pasqyra Financiare janë aprovuar nga Bordi Menaxhues më 12 shkurt 2016 dhe janë nënshkruar në emër të,


Z. Bajram Bajrami,
Drejtor Menaxhues

Shënimet nga faqja 5 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare së bashku me Shënimet përcjellëse janë përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SH.A

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të hyrat e gjeneruara nga menaxhimi i Fondit			
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 1		84,998	79,061
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 2		15,662	10,463
Tarifa hyrëse		13,610	13,344
Tarifa e daljes		4,913	4,349
		119,183	107,217
Të hyrat nga shitja e letrave me vlerë			
Rezultatet financiare, neto	14	1,862	-
Të hyrat nga interesit	15	14,313	17,236
Shpenzimet operative	16	(107,150)	(113,304)
Fitimi para tatimit		28,208	11,149
Shpenzimet e tatimit mbi fitim	17	(1,727)	-
Fitimi për vitin		26,481	11,149
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Fitimi neto në ndryshimin e vlerës së drejtë të letrave me vlerë		211	335
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse		26,692	11,484

Shënimet nga faqja 5 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SH.A

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitime të pashpërndara	Gjithsej
Gjendja me 1 janar 2014	400,000	8,613	408,613
Të ardhurat neto për vitin	-	11,149	11,149
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	335	335
Të ardhurat gjithëpërfshirës për periudhën	-	11,484	11,484
Gjendja më 31 dhjetor 2014	400,000	20,097	420,097
Të ardhurat neto për vitin	-	26,481	26,481
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	211	211
Të ardhurat gjithëpërfshirëse për periudhën	-	26,692	26,692
Gjendja më 31 dhjetor 2015	400,000	46,789	446,789

Shënimet nga faqja 5 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

		(Në Euro)	
	Shënimet	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2015	2014
Aktivitetet Operative			
Fitimi/Humbja e vitit		28,208	11,149
Zhvlerësimi/Amortizimi		9,162	9,264
Të hyrat nga interesi		(16,175)	(17,236)
Shpenzimet e interesit		1,138	1,259
Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i Fondit		(119,183)	(107,217)
Rrjedha e parasë para ndryshimeve në pasuritë operative		(96,850)	(102,781)
<i>Ndryshimet në pasuritë operative</i>			
(Maturimi)/blerja e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim		132,104	71,000
Rritja në të arkëtueshmet e tjera		5,307	(677)
Detyrimet tjera		6,754	(8,407)
Rrjedha e parasë pas ndryshimeve në pasuritë operative		47,315	(40,865)
Interesi i pranuar		13,995	16,868
Interesi i pragu		1,138	(1,259)
Tarifat e pranuar të menaxhimit me fonde		102,548	110,045
Paraja nga/(përdorur) aktivitetet operative		164,996	84,788
Aktivitetet Investuese			
(Blerja)/Shitja e pronës dhe pajisjeve		-	(5,551)
Investimi në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim		(176,721)	(34,666)
Investimi në letrat me vlerë në dispozicion për shitje		-	(24,175)
Paraja e përdorur në aktivitetet investuese		(176,721)	(64,392)
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e saj		(11,725)	20,430
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të periudhës	5	47,800	27,370
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të periudhës	5	36,075	47,800

Shënimet nga faqja 5 deri 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si "Shoqëria" ose "FSKP") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Shoqëria ka filluar operimet e saj më 04 shtator 2006. Shoqëria gjendet në Rr.UCK, nr.50/2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aksionarët kryesorë të Shoqërisë janë Prva Group PLC, Slovenia dhe Dukagjini sh.p.k., Republika e Kosovës.

Aktivitetët kryesorë të Shoqërisë janë si në vazhdim: menaxhimi i fondeve pensionale, përfaqësimi i tyre kundrejt palëve të treta si dhe aktivitetet tjera të lidhura me fondet pensionale.

Që nga zanafilla e saj deri në fillim të vitit 2008, Shoqëria ka menaxhuar një fond pensional vullnetar (më tej referuar si "Fondi 1"). Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2008, Shoqëria ka nënshkruar marrëveshje me PTK fondin në likuidim të sigurimit pensional plotësues (më tej referuar si "PTK") për menaxhimin e pasurive të tyre dhe pagesën e pensionit vjetor në çdo muaj pas planit të paracaktuar pensional të dhënë nga PTK. Pasuritë e PTK përbëjnë fondin e dytë pensional nën menaxhimin e FSKP-së (më tej referuar si "Fondi 2") dhe gjithashtu kontribuesit e transferuar nga Fondi 1 pas moshës së pensionimit.

Më 31 dhjetor 2015, Shoqëria ka kryer aktivitetet e biznesit të saj me 4 punëtorë (2014: 5 punëtorë).

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Këto politika janë zbatuar në përputhje me të gjitha vitet e prezentuara, përveç nëse është theksuar ndryshe.

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) që janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.2 Bazat e përgaditjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar politikat kontabël të rëndësishme dhe bazat e matjes përmbledhur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk shprehet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël kritike. Ajo gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

Fondi Slloveni Kosovari i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjeve të përcaktuara me SNRF për secilin lloj të pasurisë, të përgjegjësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur si dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të cekura në këto pasqyra financiare janë njohur në euro. Ku shifrat e nevojshme krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me prezantimin e vitit aktual.

2.4. Standarde dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por që ende nuk kanë hyrë në fuqi, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të bankës janë diskutuar më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

IFRS 9 Instrumentat Financiarë

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentat Financiarë që zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 sjell së bashku të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, dëmtimin dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Përveç për kontabilitetin mbrojtës, zbatimi retrospektiv kërkohet, por sigurimi i informacionit krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat janë aplikuar në përgjithësi në mënyrë prospektive, me disa përjashtime të kufizuara.

Shoqëria ka në plan të miratojë standarde të reja. Gjatë vitit 2015, Shoqëria ka kryer një vlerësim të nivelit të lartë të ndikimit të tre aspekteve të SNRF 9. Ky vlerësim është i bazuar në informacionin e disponueshëm paraprak aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që rrjedhin nga analizat e mëtejshme të hollësishme ose informacione shtesë të arsyeshme dhe të mbështetura duke u vënë në dispozicion të Shoqërisë në të ardhmen.

(a) Klasifikimi dhe Matja

Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në bilancin e saj ose në kapital në aplikimin e SNRF 9- Klasifikimi dhe Matja. Ajo pret që të vazhdojë të përdorë vlerën e drejtë në matjen e të gjitha aktiviteteve financiare të cilat aktualisht mbahen me vlerën e drejtë. Aksionet e kapitalit i cili mbahet aktualisht si i vlefshëm për shitje me fitime dhe humbje të regjistruara në të ardhurat e tjera do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, e cila do të rrisë paqëndrueshmëri në fitimin ose humbjen e regjistruar. Rezerva PVF aktualisht ka të akumuluar të ardhurat e tjera dhe do të riklasifikohen në fillim të vitit si fitim i pashpërndarë. Letrat me vlerë pritet që të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet ATP sipas SNRF 9. Shoqëria pret jo vetëm për të mbajtur aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, por edhe për të shitur një sasi të konsiderueshme në baza relativisht të shpeshta.

Aksionet e kapitalit në kompanitë e palistuara kanë për qëllim të mbahen për të ardhmen e parashikueshme. Shoqëria pret që të zbatojë mundësinë për të paraqitur ndryshimet e vlerës së drejtë në ATP, dhe, për këtë arsye, beson se zbatimi i SNRF 9 nuk do të ketë një ndikim të rëndësishëm. Nëse Shoqëria nuk do të kishte aplikuar këtë opsion, aksionet do të mbaheshin me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, e cila do të rriste paqëndrueshmërinë e fitimit ose humbjes së regjistruar.

Kreditë si dhe të arkëtueshmet tregtare mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritet të japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit. Kështu, Shoqëria pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, Shoqëria do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të bijë në përfundim se të gjitha këto instrumente kanë përmbushur kriteret për matjen e koston së amortizuar sipas SNRF 9.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.4. Standarde dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

(b) Dëmtimet

SNRF 9 kërkon që Shoqëria të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë, të letrave me vlerë, të borgjit të saj, të huave dhe të llogarive të arkëtueshme tregtare, mbi një bazë 12-mujore ose gjatë tërë eksistencës së saj. Shoqëria pret që të zbatojë humbjet e pritshme në llogaritë e arkëtueshme. Shoqëria pret një ndikim të rëndësishëm në kapitalit të saj për shkak të natyrës të pasigurtë të huave dhe llogarive të arkëtueshme të saj, por ajo do të duhej që të kryej një analizë më të detajuar e cila do ti merrte parasysh të gjitha informatat arsyeshme dhe të mbështetura, duke përfshirë elementet për të përcaktuar shkallën e ndikimit.

(c) Kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria beson se të gjitha marrëdhëniet ekzistuese të cilat janë aktualisht të përcaktuara si marrëdhënie mbrojtëse do të vazhdojnë të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Sikurse SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme se si një njësi ekonomike kontabilizon mbrojtjet efektive, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

IFRS 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 është lëshuar në maj 2014 dhe përcakton një model pesë-hapësh që do të aplikojë për të ardhurat e fituara nga klientët. Sipas SNRF 15, të hyrat njihen në një shumë që pasqyron vlerësimin për të cilin Shoqëria pret ta njoh në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve një klienti.

Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale për njohjen e të ardhurave sipas SNRF-ve. Ose një aplikim i plotë retrospektiv ose një aplikim retrospektiv i modifikuar është i nevojshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, kur BSNK të ketë finalizuar ndryshimet e tyre për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 për një vit. Aplikimi i mëhershëm është i lejuar. Shoqëria është në procesin e vlerësimit të ndikimit në pasqyrat e saj financiare nga SNRF 15.

Ndryshimet në SNK 16 and SNK 38: Sqarimi i Metodave të Pranueshme të zhvlerësimit të Amortizimit

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 qartësojnë se parimet në të ardhurat që pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të krijuara nga operimi i një biznesi (i të cilit pasurie është pjesë) sesa përfitimet ekonomike që janë konsumuar nëpërmjet përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, një metodë e bazuar në të ardhura mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe pajisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e aktiveve jo-materiale. Ndryshimet janë efektive në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në Shoqëri duke pasur parasysh se Shoqëria nuk ka përdorur një metodë të bazuar në të ardhura për të zhvlerësuar asetet e saj afatgjata.

Përmirësimet vjetore të ciklit 2012-2014

Këto përmirësime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ato përfshijnë:

SNRF 5 Pasuritë Jo - Qarkulluese që Mbahen për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera

Pasuritë (amendamenti sqaron se në ndryshim nga një nga metodat për hedhjen në tjetrën (përmes shitjes apo përmes shpërndarjes për pronarët) nuk duhet të konsiderohet të jetë një plan i ri i disponueshem, por ajo është një vazhdim i planit origjinal.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

2.4. Standarde dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

(i) Kontratat e Shërbimit

Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një pasuri financiare. Një Shoqëri duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe rregullimin kundër udhëzimit të përfshirjes së vazhdueshme në SNRF 7 në mënyrë që të vlerësohet nëse shpalosjet e informacioneve shpjeguese janë të nevojshme. Vlerësimi i cilës kontratë të shërbimit përbën përfshirjen e vazhdueshme që duhet bërë në mënyrë retrospektive. Megjithatë, shpalosjet e kërkuara nuk do të duhet të sigurohen për çdo periudhë që fillon para periudhës vjetore në të cilën Kompania i zbaton ndryshimet së pari.

(ii) Zbatimi i ndryshimeve të SNRF 7 për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Ndërmjetme

Ndryshimi sqaron se kërkesat për kompensim në dhënien e informacioneve shpjeguese nuk zbatohen për pasqyrat financiare të konsoliduara të ndërmjetme, përveq nëse shpalosjet e tilla sigurojnë një përditësim të rëndësishëm në informacionin e raportuar në raportin më të fundit vjetor.

SNK 19 Përfitimet e Punonjësve

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, në vend se vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, normat e bonove qeveritare duhet të përdoren.

Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa e shpalosjeve

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë, më shumë se ndryshimet e rëndësishme, kërkesat aktuale të SNK 1. Ndryshimet sqarojnë:

- Kërkesat materiale në SNK 1
- Se zëra specifike në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe IKO dhe në pasqyrën e pozicionit financiarë, mund të ndahen.
- Se subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilin ata i paraqesin shënimet në pasqyrat financiare.
- Se pjesa e ATP të pjesëmarrësve dhe sipërmarrësve të përbashkët të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit duhet të paraqiten në total si një zë, dhe të klasifikuar mes atyre zërave që do të jenë apo nuk do të jetë më pas të riklasifikuara në fitim ose humbje.

Më tej, ndryshimet sqarojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën (at) e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera dhe IKO. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në Shoqëri.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

2.5. Standardet dhe interpretimet e lëshuara të cilat nuk janë efektive apo të zbatueshme në Shoqëri

Standardet e tjera apo ndryshimet që janë lëshuar që nuk janë efektive dhe të zbatueshme për të Shoqërinë janë:

SNRF 14 Llogaritë pezull

SNRF 14 është një standard opsional që lejon një njësi ekonomike, aktivitetet e të cilës i nënshtrohen normës-rregullative, për të vazhduar aplikimin e politikave të saj ekzistuese të kontabilitetit për rregullimin llogarive pezull. Subjektet që adoptojnë SNRF 14 duhet të paraqesin llogaritë pezull si zëra të veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe lëvizjet e pranishme në këto llogari si zëra të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e të ardhurave të tjera. Standardi kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për natyrën si dhe rreziqet që lidhen me të, të normës-rregullative të njësisë ekonomike dhe efektet e kësaj normë-rregullative në pasqyrat e saj financiare. SNRF 14 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016. Pasi që nga Shoqëria ka përgatitur SNRF-të eksistuese, ky standard nuk do të zbatohet.

Ndryshimet në SNRF11 *Marrëveshjet e përbashkëta: Kontabiliteti për Blerjet e Interesave*

Ndryshimet në SNRF 11 kërkojnë që një operator i përbashkët i kontabilitetit për blerjen e një interesi në një operacion të përbashkët, në të cilën veprimtaria e operacionit të përbashkët përbën një biznes, duhet të aplikojnë parimet përkatëse të SNRF 3 për kombinimet e biznesit të kontabilitetit. Ndryshimet gjithashtu sqarojnë se një interes i mbajtur më parë në një operacion të përbashkët nuk është matur në blerjen e një interesi shtesë në të njëjtin operacion të përbashkët, ndërsa kontrolli i përbashkët është mbajtur. Përveç kësaj, një përjashtim nga objektivi është shtuar në SNRF 11 për të specifikuar se ndryshimet nuk zbatohen kur palët që ndajnë kontroll të përbashkët, duke përfshirë njësitë raportuese, janë nën kontroll të përbashkët të së njëjtës parti e cila ushtron kontrollin përfundimtar.

Ndryshimet zbatohen për të dy rastet, blerjen e interesit fillestar në një operacion të përbashkët dhe blerjen e çdo interesi shtesë në të njëjtin operacion të përbashkët dhe janë në mënyrë prospektive efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk priten të kenë ndonjë ndikim në Shoqëri.

Ndryshimet në SNK 16 dhe në SNK 41 *Aktivët Bujqësorë*

Ndryshimet ndryshojnë kërkesat e kontabilitetit për aktivët bujqësorë që plotësojnë përkufizimin e bartesit të pajisjeve. Sipas ndryshimeve, aktivët biologjike që plotësojnë përkufizimin e bartesit të pajisjeve nuk do të jetë brenda objektit të SNK 41. Në vend të kësaj, SNK 16 do të zbatohet. Pas njohjes fillestare, bartësi i pajisjeve do të matet në bazë të SNK 16 me kosto të akumuluar (para maturimit) dhe duke përdorur ose modelin e koston ose modelin e rivlerësimit (pas maturimit). Ndryshimet gjithashtu kërkojnë që prodhimi të rritet në bartesin e pajisjeve do të mbetet në objektin e SNK 41 të matur në vlerë të drejtë minus kostoja e shitjes. Për grantet qeveritare të lidhura me bartesin e pajisjeve, SNK 20 Kontabiliteti për *Grantet Qeveritare dhe Dhënia e informacioneve* shpjeguese për ndihmën qeveritare do të zbatohet. Ndryshimet janë në mënyrë retrospektive në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk priten të kenë ndonjë ndikim për Shoqërinë pasi që Shoqëria nuk ka ndonjë bartës të pajisjeve.

Ndryshimet në SNK 27: *Pasqyrat Financiare Individuale*

Amendamenti hyn në fuqi nga 1 janar 2016. Ajo do të lejojë njësitë ekonomike për të përdorur metodën e kapitalit neto për të kontabilizuar investimet në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe bashkëpunëtorë në pasqyrat financiare individuale të tyre dhe do të ndihmojë në disa juridiksione të shkojë në SNRF për pasqyrat financiare të veçanta, duke reduktuar kostot e pajtueshmërisë pa zvogëluar informacionin në dispozicion për investitorët. Shoqëria aktualisht nuk ka investime në subjektet e tjera dhe amendamentet nuk do të ndikojnë Shoqërinë.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Standardet dhe interpretimet e lëshuara të cilat nuk janë efektive apo të zbatueshme në Shoqëri (vazhdim)

Ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta

Ndryshimet që trajtojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 që kanë të bëjnë me humbjen e kontrollit të një filiali që është shitur apo kontribuar në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aseteve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, në mes të një investitori dhe pjesëmarrësve ose sipërmarrësve të përbashkët të saj, është e njohur në mënyrë të plotë. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aseteve të cilat nuk përbëjnë një biznes, megjithatë, është e njohur vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Këto ndryshime duhet të zbatohen në mënyrë prospektive dhe janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në Shoqëri.

SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm

Ndryshimi sqaron se informacionet e përkoshme shpjeguese të kërkuara duhet të jenë ose në pasqyrat financiare të konsoliduara ose të përfshihen nëpërmjet referencës së kryqëzuar në mes të pasqyrave financiare të konsoliduara dhe kudo që janë të përfshira në raportin financiar të ndërmjetëm (p.sh. në komentin e menaxhimit ose raportin e rrezikut). Informacioni tjetër në raportin financiar të konsoliduar duhet të jetë në dispozicion për përdoruesit në të njëjtat terma si pasqyrat financiare të përkoshme dhe në të njëjtën kohë. Ky ndryshim duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive.

Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në Shoqërinë.

- Ndryshimi në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 *Shoqëritë Investuese: Aplikimi i Përrjashtimeve nga Konsolidimet*

Ndryshimet adresojnë çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e subjekteve investitore sipas SNRF 10. Ndryshimet në SNRF 10 sqarojnë se përjashtimi nga paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara zbatohet për një njësi ekonomike mëmë që është një degë e një njësie ekonomike të investimeve, kur entitetet e investimeve të të gjitha filialave të saj maten me vlerën e drejtë.

Për më tepër, ndryshimet në SNRF 10 sqarojnë se vetëm një degë e një njësie ekonomike të investimeve që nuk është një entitet investim në vetvete dhe që ofron shërbime mbështetëse për subjektin investues është konsoliduar. Të gjitha degët e tjera të një njësie ekonomike investuese maten me vlerën e drejtë. Ndryshimet në SNK 28 lejon investitorin, kur të aplikojë metodën e kapitalit neto, të mbajnë matjen e vlerës së drejtë aplikohen nga subjekti investiv pjesëmarrës ose sipërmarrje të përbashkët me interesat e saj në filiale.

Këto ndryshime duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive dhe janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim për Shoqërinë.

2.6. Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e tyre

Ndryshimet në SNK 19 Skemat me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve

SNK 19 kërkon që Shoqëria të marrë në konsideratë kontributet nga punonjësit ose palët e treta, për skemat me përfitime të përcaktuara. Në rastet kur kur kontributet janë të lidhura me shërbimin, Kompania duhet t'i atribuohet periudhës së shërbimit si një përfitim negativ. Këto ndryshime sqarojnë se, në qoftë se shumica e kontributeve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit, mund të trajtohen si ulje e kostos së shërbimit në periudhën në të cilën është kryer shërbimi përkatës. Këto ndryshime vlejnë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2014. Ky ndryshim nuk është relevant për Shoqërinë, pasi asnjë nga subjektet brenda Kompania nuk ka përcaktuar skemat me përfitime të përcaktuara me kontributet nga punonjësit ose palët e treta.

Përmirësimet Vjetore të ciklit 2010-2012

Me përjashtim të përmirësimit lidhur me SNRF 2, *pagesat e bazuara në aksione* aplikohen në transaksionet e pagesave të bazuara në aksione me datën e dhënies në ose pas 1 korrik 2014, të gjitha përmirësimet e tjera janë efektive për periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014.

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6. Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e tyre (vazhdim)

SNRF 2 Pagesa e Bazuar në Aksione

Ky përmirësim është aplikuar në mënyrë prospektive dhe sqaron çështje të ndryshme në lidhje me përkufizimin e performancës dhe shërbimit të kushteve të cilat janë të kushtëzuara. Sqarimet janë në përputhje me mënyrën se si Shoqëria ka identifikuar kushtet e performancës dhe shërbimit të cilat janë të kushtëzuara në periudhat e mëparshme. Përveç kësaj, Shoqëria nuk ka dhënë ndonjë çmim gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014 dhe 2015.

SNK 16 Prona, Impiantet e prodhimit dhe Makineritë dhe SNK 38 Pasuritë e paprekshme

Ndryshimi është aplikuar në mënyrë retrospektive dhe sqaron në SNK 16 dhe SNK 38 që pasuritë mund të jetë rivlerësuar duke iu referuar të dhënave të vëzhguara duke rregulluar shumën bruto kontabël të pasurive me vlerën e tregut ose me përcaktimin e vlerës së tregut të vlerës kontabël dhe rregullimin e vlerës kontabël bruto në mënyrë proporcionale në mënyrë që të rezultojë se vlera kontabël është e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, amortizimi i akumuluar apo amortizimi është diferenca mes shumave bruto dhe neto të pasurive.

SNK 24 Shpalosjet mbi palët e ndërlidhura

Ndryshimi është aplikuar në mënyrë retrospektive dhe sqaron se menaxhmenti i Shoqërisë (një njësi ekonomike që ofron shërbime të rëndësishme të menaxhimit të personelit) është një palë e ndërlidhur në dhënien e informacioneve shpjeguese për palët e ndërlidhura. Përveç kësaj, një njësi ekonomike që përdor një njësi të menaxhimit është e nevojshme për të shpalosur shpenzimet e bëra për shërbimet e menaxhimit.

Përmirësimet Vjetore Cikli 2011-2013

Këto ndryshime janë në fuqi nga 1 korrik 2014 dhe Shoqëria ka aplikuar këto ndryshime për herë të parë në këto pasqyra financiare të konsoliduara. Ato përfshijnë:

SNK 13 Matja me vlerën e drejtë

Ndryshimi zbatohet në mënyrë prospektive dhe sqaron se përjashtimi i portofolis në SNRF 13 mund të aplikohet jo vetëm për pasuritë financiare dhe pasivet financiare, por edhe për kontratat e tjera brenda objektivit të SNK 39.

SNK 40 Investimet në Pronë

Përshkrimi i shërbimeve ndihmëse në SNK 40 bën dallimin mes pronës së investuar dhe pronës së zotëruar nga pronari (dmth., pronës, impianteve dhe pajisjeve). Ky standart nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë

2.7 Këmbimi i valutave të huaja

Valuta funksionale dhe e prezantuar

Artikujt e përfshirë në pasqyrat financiare maten duke filluar valutën e hapësirës primare ekonomike në të cilën entiteti operon ("valuta funksionale"). Këto pasqyra financiare janë të prezentuara në Euro, e cila është valuta funksionale dhe prezentuese e Shoqërisë.

Transaksionet dhe balancat

Transaksionet e valutës së huaj janë transferuar në valutën funksionale duke përdorur normën e këmbimit që mbizotëron në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet e këmbimit të huaj që rezultojnë nga zgjidhja e transaksioneve të tilla dhe nga transferimi në normat e këmbimit të fund-vitit të pasurive monetare dhe detyrimeve të emëruara në valutën e huaj janë riorganizuar në fitim dhe humbje.

2.8 Kompensimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes ku ekziston e drejta e imponueshme ligjore për të mënjanuar shumat e njohura dhe ka synim për tu vendosur në baza neto, apo për të realizuar pasurin dhe në të njëjtën kohë për të shlyer detyrimin

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur kur ekziston mundësia që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Shoqëri dhe këto benefite të mund të maten me besueshmëri.

Shoqëria njihet të ardhurat duke ngarkuar llojet e tarifave në vazhdim:

- Tarifa hyrëse e barabartë me 3% nga shuma totale e kontributeve të paguara në Fondin 1, përpara se kontributet të konvertohen në njësi kontabël;
- Tarifa menaxheriale e barabartë më 1.5% në baza ditore e pasurive totale të Fondit 1;

Përqindja e interesit të pranuar në pasurive e depozituara të Fondit 2 dhe në bazë të vendimeve të menaxhimit.

2.10 Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për të gjitha interesat e pasurive dhe detyrimeve financiare duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.11 Të hyrat dhe komisionet nga tarifat

Të hyrat dhe komisionet nga tarifat njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse në baza akruale pasi të sigurohet shërbimi.

2.12 Të hyrat nga dividendët

Dividentët njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse kur është përcaktuar e drejta e entitetit për të pranuar pagesën.

2.13 Pasuritë financiare

Shoqëria i klasifikon pasuritë e saj sipas kategorive në vazhdim: pasuritë financiare me vlerë reale përmes fitimit dhe humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet dhe të gatshmet për shitje dhe pasuritë e mbajtura deri në maturim. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

(a) Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregëtim dhe ato të përcaktuara në vlerën përmes fitimit ose humbjes në fillim. Një pasuri financiare është klasifikuar në "pasuri financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" kategori në fillim të merret kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, në qoftë se ajo është pjesë e një portofoli të pasurive financiare në të cilën ka dëshmi të fitimit afatshkurtër, ose nëse është përcaktuar kështu nga menaxhmenti.

(b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre që Shoqëria synon të shesë në afat të shkurtër apo se ajo ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes apo në dispozicion për shitje. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, më pak dispozitë për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të huave dhe llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me termat e tyre origjinale.

Të arkëtueshmet tregtare janë klasifikuar në këtë kategori. Ata njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me shumat e rikuperueshme, më pak dispozitë për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim e të arkëtueshmeve tregtare krijohet kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë falimentimit ose riorganizime financiare, dhe mospagesa ose vështirësi në pagesat (më shumë se 30 ditë vonesë) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar.

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.13 Pasuritë financiare (vazhdim)

Vlera e bartur e pasurive ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes, dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, ajo shlyhet kundrejt llogarisë së kompensimit për të arkëtueshmet tregtare. Arkëtimet pasuese të llogarive paraprkasht të shlyera kreditohen në fitim ose humbje.

(c) Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse të tjera nga ato që plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme që menaxhmenti i Shoqërisë ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Këto pasuri njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionet për dëmtime. Një dispozitë për zhvlerësim të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim është krijuar kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve të tyre origjinale

(d) Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë pasuri financiare jo-derivative të cilat ose janë caktuar në këtë kategori ose jo klasifikuar në asnjë nga kategoritë e tjera. Shoqëria ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori.

Njohja fillestare dhe mosnjohja

Blerjet në mënyrën e rregullt-dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit - data në të cilën Shoqëria angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Pasuritë financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha pasurive financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes së tyre. Pasuritë financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të njihen fillimisht me vlerën e drejtë, dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitim ose humbje.

Pasuritë financiare njihen kur të drejtat për të marrë flukse monetare prej tyre kanë skaduar ose kur Shoqëria ka transferuar edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Matja e mëpasshme

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje dhe pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë mbajtur më pas me vlerën e drejtë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive financiare 'me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes' kategorinë e përealizuara përfshihen në fitimin ose humbjes në periudhën në të cilën lindin. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë jo-monetare të klasifikuara si të disponueshme për shitje përealizuara njihen në kapitalin neto. Kur letrat me vlerë të klasifikuara investime në dispozicion për shitje janë shitur ose zhvlerësohen, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë përfshihen në fitim ose humbje si fitimet / humbjet të realizuara nga pasuritë financiare.

Interesi në letrat me vlerë në dispozicion për shitje duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe është njohur në fitim ose humbje. Dividendët për instrumentet e kapitalit neto të vlefshme për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave kur e drejta e Shoqërisë për të marrë pagesat është themeluar. Të dy janë të përfshira në vijën e të ardhurave të investimeve.

Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar mbështeten në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një pasuri financiar nuk është aktiv, Shoqëria vendos vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit së, referencë në instrumente të tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e skontimit të flukseve monetare etj.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.14 Zhvlerësimi i pasurive financiare

Pasuritë e bartura në koston e amortizuar

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Shoqëria vlerëson në çdo pasyqrë të datës së pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një pasuri financiare është e dëmtuar. Një pasuri financiare ose një grup i pasurive financiare është i dëmtuar dhe humbjet nga rënia janë kryer vetëm nëse ekziston evidencë objektive e zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë (një "rast humbje") dhe që rast humbje (ose ngjarje) ka një ndikim në rrjedhat e vlerësuarat monetare të ardhshme të pasurisë financiar ose grup pasurish financiar që mund të vlerësohen me besueshmëri.

Shuma e humbjes nga zhvlerësimi është llogaritur si diferencë mes vlerës së pasurisë dhe vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredititit) e zbritur me normën fillestare efektive të pasurisë financiare të interesit. Të arkëtueshmet me afat të shkurtër maturimi nuk janë zbritur. Shuma e bartur e pasurisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një kompensimi për dëmtim dhe shuma e humbjes nga zhvlerësimi është njohur në fitimet dhe humbjet e tanishme.

Pasuritë e klasifikuara në dispozicion për shitje

Shoqëria vlerëson në çdo pasyqrë të datës së pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një pasuri financiare është dëmtuar. Rënie e rëndësishme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të pasurisë financiare nën kosoton e tij është konsideruar si dëshmi objektive në përcaktimin nëse pasuritë janë të dëmtuara. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston për pasuritë financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative-e matur si diferenca midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale njihet në fitimet dhe humbjet aktuale. Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit klasifikohet si e vlefshme për rritjen e shitjes dhe rritja mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pas humbjes nga zhvlerësimi të cilat janë të njohura në fitimin ose humbjen e tanishme, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet fitimeve dhe humbjeve.

2.15 Pasuritë e patrupëzuara

Programi i kompjuterit

Shpenzimet që lidhen me zhvillimin ose mirëmbajtjen e programeve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin që ndodhin. Kostot që lidhen drejtëpërdrejt me produkte programesh të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga Shoqëria që do të gjenerojnë përfitime ekonomike që tejkalojnë shpenzimet përtej një viti njihen si aktive jo-materiale. Kostot e zhvillimit të programeve kompjuterike të njohura si pasuri janë amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë një periudhe prej pesë vitesh

Pasuritë tjera të patrupëzuara

Shpenzime që fitojnë të drejtë dhe licencë janë kapitalizuar dhe amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së përdorimit.

2.16 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet janë bartur në koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar.

Zhvlerësimi ngarkohet mbi një bazë lineare në mënyrë që të ndahet kostoja e vlerësuar e pronës dhe pajisjeve mbi kohën e tyre të përdorimit. Në vazhdim janë normat vjetore të përafërta të aplikuarat për artikujt e rëndësishëm të pronës dhe pajisjeve:

Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

	<i>Në datën e bilancit</i>
Kompjuterët	20%
Pajisjet tjera	20%
Pasuritë e patrupëzara	20%

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.16 Prona dhe paisjet (vazhdim)

Blerjet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurisë apo janë njohur si pasuri të ndara, sipas rastit, vetëm kur ekziston mundësia e fluksit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të Shoqërisë lidhur me zërin dhe kur vlera e blerjes e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera i ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave si shpenzim gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e përshtatshme, në çdo datë të paqyrës së pozicionit financiar.

Shuma bartëse e një pasurie është shkruar menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shumata që vlerësohet të merret.

Fitimet dhe humbjet nga heqjet janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

2.17 Zhvlerësimi i pasurive jo financiare

Pasuritë që janë subjekt i zhvlerësimit/amortizimit rishikohen për zhvlerësim kurdo që ngjarja ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës së drejtë të një pasurie minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim.

2.18 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhes së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet me afat maturimi me më pak se 90 ditë nga data e blerjes dhe përbëjnë vetëm para dhe plasmanet me bankat.

2.19 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria nuk bën asnjë provision dhe nuk ka obligim shtesë për të paguar pensionet e punonjësve përveç kontributet e paguara në planin pensional shtetëror, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

2.20 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit aktual të pagueshëm dhe tatimit të shtyrë.

Tatimi i pagueshëm aktualisht llogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin nr 03/L-162. Tatimi final mbi fitimin në normën prej 10 % (2014:10%) është i pagueshëm duke u bazuar në fitimin vjetor të paraqitur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe të rregulluar për artikujt të cilët janë të pa tatueshëm ose të palejuar. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet tatimore mund të barten për tu vendosur në pesë vitet e ardhshme pas vitit në të cilin ka ndodhur humbja tatimore.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave është dhënë në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimeve, që rrjedhin nga diferencat e përkohshme ndërmjet bazave tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Normat e tatimit të miratuara aktualisht përdoren në përcaktimin e tatimit në të ardhura të shtyra. Tatimi i shtyrë ngarkohet ose kreditohet në pasqyrën e të ardhurave përveç kur ajo lidhet me artikujt e ngarkuar ose kredituar direkt në ekuitet, me ç'rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në ekuitet.

Pasuritë e tatimit të shtyrë janë njohur deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme.

Shoqëria nuk ka njohur ndonjë detyrim të shtyrë tatimor apo pasuri më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, pasi nuk ka pasur dallime materiale të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.21 Huatë

Huatë njihen fillimisht me vlerën e tyre reale të flukseve hyrëse të pranuar, minus kosotot e ngarkuara për transaksion. Huatë më pas janë deklaruar me vlerën e tyre të amortizuar të blerjes.

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.22 Kapitali aksionar

a) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

b) Kostot që lidhen me emetimin e aksioneve

Kostot që lidhen më çështjet e aksioneve të reja, opsionet ose aktivitetet e biznesit janë paraqitur në kapital si një reduktim neto nga tatimi i të hyrave.

c) Rezervat

Rezervat, të cilat përbëhen nga rivlerësimi dhe rezervat statuore, janë të krijuara gjatë gjithë periudhës, bazuar në fitime/humbje nga rivlerësimi i pasurive financiare dhe jo financiare, sikurse shpërndarja e fitimeve të akumuluar në bazë të rregullatave ligjore dhe vendimeve nga ana e menaxhmentit të Shoqërisë.

(e) Fitimet e pashpërndara

Fitimet e pashpërndara përbëhen nga fitimet e pashpërndara nga periudhat aktuale dhe të kaluara.

(f) Dividentët e aksioneve të zakonshme

Dividenda e aksioneve të zakonshme njihet në periudhen kur miratohen nga aksionarët e Shoqërisë.

Dividentët për vitin që janë botuar pas datës së bilancit janë shpalosur në shënimin e ngjarjeve të mëvonshme

2.23 Informata krahasuse

Ku është e aplikueshme, është bërë riklasifikimi i shifrave krahasuse për të paraqitur ndryshimet në vitin aktual.

2.24 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Përveq kësaj, një pasuri kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se një detyrim i pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.25 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura janë definuar si ato palë të cilat kanë kontroll mbi njëri-tjetrin ose që kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëri tjetrit.

Palët e lidhura të Shoqërisë janë Prva Group PLC nga Ljubljana Slloveni dhe korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët janë aksionarë të Shoqërisë.

2.26 Ngjarjet pas datës raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Shoqërisë në datën pasqyës së pozitës financiare (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë rregulluar janë shpalosur në shënime kur kanë qenë materiale.

Fondi Slloveni Kosovari i Pensioneve Sh.a

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e Shoqërisë janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie të risqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Qëllimi i Shoqërisë është që të arrihet një balancë e përshtatshme mes rrezikut dhe të kthimit për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur limitet e duhura të riskut dhe kontrollet dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve nëpërmjet sistemeve të besueshme të informacionit dhe modern. Shoqëria rishikon rregullisht politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i riskut kryhet nga menaxhmenti i Shoqërisë nën politikat e aprovuara nga Bordi Mbikqyrës. Menaxhmenti i identifikon dhe vlerëson rreziqet financiare në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e Shoqërisë operative. Bordi Mbikqyrës siguron politika dhe procedura të shkruara për menaxhimin e riskut të përgjithshëm si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, si risku i këmbimit valutor, risku i normës së interesit.

Përqëndrimi i risqeve të pasurive financiare sipas sektorëve gjeografik

Tabela në vijim paraqet ekspozimin kryesor kreditor të Shoqërisë në shumatat bartëse, të kategorizuara sipas rajonit gjeografik si më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 në Euro.

	Republika e Kosovës	EU	Gjithsej
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	23,020	13,055	36,075
Letrat më vlerë të mbajtura deri në maturim	167,619	176,819	344,438
Letrat më vlerë në dispozicion për shitje	-	24,662	24,662
Pasuritë tjera	53,505	-	53,505
Gjithsej më 31 dhjetor 2015	244,144	214,536	458,680
Gjithsej më 31 dhjetor 2014	199,656	216,417	416,073

Risku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të tregut. Risqet e tregut dalin nga pozicioni i hapur i Shoqërisë ndaj efektit të luhatjeve në nivelin dominues të normave të interesit të tregut, si dhe nga efekti i luhatjeve në normat e këmbimit të valutave të huaja. Menaxhmenti i Shoqërisë vendos limitet e vlerës së riskut që mund të pranohen, i cili është kryesisht i bazuar në monitorim të përditshëm.

Risku kreditor

Vlera e bartur e pasurive financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	2015	2014
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	35,786	47,740
Letrat më vlerë të mbajtura deri në maturim	344,438	301,005
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	24,662	24,452
Pasuritë tjera	53,506	42,816
Gjithsej më 31 dhjetor	458,392	416,013

Risku i normës së interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset e mjeteve monetare.

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Shoqërisë ndaj riskut të normës së interesit. Pozicioni i Shoqërisë në aspektin e ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve të normave të interesit në momentin e rivendosjes së normës së interesit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është paraqitur më poshtë. Përfshihen instrumentet financiare të Shoqërisë në vlerën e tyre aktuale, bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit (në Euro):

Fondi Silloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Risku i normës së interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2015	Më pak se 1 muaj	Prej 1 deri 12 muaj	Prej 1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	36,075	-	-	-	-	36,075
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	9,814	280,796	48,862	4,966	344,438
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	24,385	-	277	24,662
Pasuritë tjera	-	-	-	-	53,505	53,505
Gjithsej pasuritë	36,075	9,814	305,181	48,862	58,748	458,680
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	-	-	-	-	15,358	15,358
Gjithsej detyrimet	-	-	-	-	15,358	15,358
Hapësira e rrezikut të normës së interesit neto	36,075	9,814	305,181	48,862	43,390	443,322
31 dhjetor 2014						
Gjithsej pasuritë	47,800	-	319,898	-	48,375	416,073
Gjithsej detyrimet	-	-	-	-	6,131	6,131
Hapësira e normës së interesit neto	47,800	-	319,898	-	42,244	409,942

Risku i monedhës

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës së huaj pasi që të gjitha transaksionet e saj kryhen në monedhën vendase.

Risku i likuiditetit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat maturimi, zbrazjeve të huave dhe tërheqjeve tjera të parave.

Tabelat e mëposhtme analizojnë pasuritë dhe detyrimet e Shoqërisë, të grupuara sipas maturitetit të tyre përkatës, bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit (në Euro).

31 dhjetor 2015	Më pak se 1 muaj	Prej 1 deri 3 muaj	Prej 3 deri 12 muaj	Prej 1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	36,075	-	-	-	-	36,075
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	14,779	280,796	48,863	344,438
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	277	24,385	-	24,662
Pasuritë tjera	-	-	53,505	-	-	53,505
Gjithsej pasuritë	36,075	-	68,561	305,181	48,863	458,680
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	-	-	15,358	-	-	15,358
Gjithsej detyrimet	-	-	15,358	-	-	15,358
Hapësira neto e likuiditetit	36,075	-	53,203	305,181	48,863	443,322
31 dhjetor 2014						
Gjithsej pasuritë	47,800	-	48,375	319,898	-	416,073
Gjithsej detyrimet	-	-	6,131	-	-	6,131
Hapësira neto e likuiditetit	47,800	-	42,244	319,898	-	409,942

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Vlera e drejtë e letrave me vlerë jo të kuotuar në tregun aktiv

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të tilla të pa kuotuar në një treg aktiv mund të përcaktohet nga Shoqëria duke përdorur burime të çmimeve (të tilla si agjenci çmimesh) ose çmimet treguese nga obligacionet/borxhet e tregut. Komisioneri citon se të arriturat nga burimet e çmimeve mund të jenë tregues dhe jo ekzekutues ose të detyrueshëm. Shoqëria do të ushtrojë gjykimin dhe vlerësimet për sasinë dhe cilësinë e burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna të tregut në dispozicion, Shoqëria mund të vë çmim për pozicionet duke përdorur modelet e veta, të cilat janë zakonisht të bazuara në metodat e vlerësimit dhe teknikat e njohura përgjithësisht si standarde përbrenda industrisë. Inputet në këto modele janë kryesisht të fituara shumëfish dhe flukset e parasë të skontuara. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikuara në mënyrë periodike nga ana e personelit më përvojë, të pavarur nga pjesa që ka krijuar ato. Modelet e përdorura për letrat me vlerë të kapitalit privat janë të bazuara kryesisht në të ardhurat e shumëfisha (bazuar në të ardhurat historike të emetuesit gjatë dekadës së kaluar) dhe flukset e parasë të skontuara. Modelet e përdorura për letrat me vlerë të borxhit janë bazuar në vlerën neto aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme, të përshtatura sipas nevojës për likuiditet, dhe e kreditit dhe faktorët e rrezikut të tregut.

Modelet përdorin të dhëna të vëzhgueshme, në një masë të realizueshme. Megjithatë, fusha të tilla si e rrezikut të kredisë (të dyja dhe pala tjetër), luhatjet dhe korelacionet kërkojnë menaxhmentit për të bërë vlerësime. Ndryshimet në supozimet për këta faktorë mund të ndikojnë në vlerën e raportuar të drejtë të instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës reale

Vlera reale paraqet shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në baza duarilire. Vlerat reale janë bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas profilit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të matura më vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki mbledh pasuritë dhe detyrimet financiare në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së pasurive:

- a) **Niveli 1:** Çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për mjetet ose detyrimet identike
- b) **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit bazohen në të dhëna të vëzhgueshme të tjera përveç çmimeve të kuotuar, qoftë drejtpërdrejt (p.sh. si çmimet) ose tërthorazi (p.sh. rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë drejtpërdrejtë ose tërthorazi të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- c) **Niveli 3:** Teknikat e vlerësimit që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet ku metoda e vlerësimit përfshin inpute jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet jo të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme ku rregullime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime janë të nevojshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e vlerave të drejta mbi hierarkitë e ndryshme të vlerës së drejtë.

31 dhjetor 2015

	Gjithsej Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare				
Instrumentet e borxhit	24,662	24,662	-	-
Gjithsej pasuritë financiare në dispozicion për shitje	24,662	24,662	-	-

31 dhjetor 2014

	Gjithsej Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare				
Instrumentet e borxhit	24,452	24,452	-	-
Gjithsej pasuritë financiare në dispozicion për shitje	24,452	24,452	-	-

Instrumentet financiare jo të matura me vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë (në Euro).

Shënime	Huatë dhe të arketuëshmet	Të mbajtura deri në maturim		Kosto tjera të amortizimit	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2015						
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	36,075	-	-	36,075	36,075
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	7	-	344,438	-	344,438	356,088
Pasuritë tjera	11	53,505	-	-	53,505	53,505
		89,580	344,438	-	434,018	445,668
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	12	-	-	15,318	15,318	15,318
		-	-	15,318	15,318	15,318
31 dhjetor 2014						
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	47,800	-	-	47,800	47,800
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	7	-	301,005	-	301,005	313,544
Pasuritë tjera	11	42,816	-	-	42,816	42,816
		90,616	301,005	-	391,621	404,160
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	12	-	-	6,131	6,131	6,131
		-	-	6,131	6,131	6,131

Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim

Vlera e drejtë e pasurive financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv është e vendosur duke përdorur supozimet në bazë të kushteve të tregut ekzistues në çdo datë të bilancit të gjendjes.

Pasuritë tjera financiare

Vlera e drejtë e mjeteve monetare që përfshin paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet e përafërt me vlerat e tyre kontabël sipas definicionit dhe për shkak të maturitetit të tyre më pak se 3 muaj.

Të pagueshmet tjera

Vlera bartëse e të pagueshmeve të tjera përafron vlerën e tyre të drejtë për shkak të maturitetit të tyre më pak se 3 muaj.

Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë për sa i përket menaxhimit të kapitalit janë:

- Të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e kapitalit nga rregullatori,
- Të ruajë aftësinë e Shoqërisë që të vazhdojë të operojë si entitet funksionues, dhe
- Të mbajë një bazë të fortë të kapitalit për të mbështetur zhvillimin e bizneseve të saj.

Shoqëria është e obliguar të menaxhojë strukturën e kapitalit të saj e cila përbëhet nga borxhi, paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe kapitali i kontribuar i zotëruesve të kapitalit, përfshirë kapitalin e paguar dhe fitimet e mbajtura earnings.

4. VLERËSIMET KRITIKE KONTABËL DHE GJYKIMET

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

a) *Vlera e drejtë e instrumenteve financiare*

Ku vlerat e drejta e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve matematikore. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje të Shoqërisë janë vetëm pasuritë e matura me vlerën e drejtë dhe ato nuk janë të rëndësishme për aktivet financiare të përgjithshme. Për qëllim të publikimit të vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve të tjera financiare, modelet e vlerësimit janë përdorur të bazuara në të dhëna të dukshme të tregut aty ku është e mundur, por nëse kjo nuk është e mundshme, gjykimi është i nevojshëm për të krijuar vlerat e drejta.

b) *Tatimi*

Shoqëria është subjekt i ligjeve tatimore në Republikën e Kosovës. Menaxhmenti përdor vlerësimin e tij më të mirë dhe gjykimin në përputhje të plotë me ligjet përkatëse tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimit në përputhje me kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimet tatimore mund të ndryshojnë në krahasim me atë të raportuar në pasqyrat financiare, megjithatë menaxhmenti është i bindur se nuk mund të dalin dallime materiale.

Fondi Slloveni Kosovari i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paraja e gatshme	289	60
Llogari rrjedhëse – Kasabank	2,377	21,737
Llogari rrjedhëse - Raiffeisen Bank, Kosovë	19,137	20,148
Llogari rrjedhëse – Banka Qëndrore e Kosovës	117	140
Llogari rrjedhëse - Banka Ekonomike	0	14
Llogari rrjedhëse – TEB	1,100	1,319
Llogaria e kursimeve – Poteza	13,055	4,382
	36,075	47,800

Llogaria e kursimeve kryesisht përdoret për operacione jashtë vendit të tilla si blerjen e letrave me vlerë të reja, marrja e maturimit të letrave me vlerë.

6. LETRAT ME VLERË TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Letrat me vlerë të borxhit	329,658	182,723
Letrat komerciale	9,814	-
Plasmanet në banka	-	113,000
Interesi i përllogaritur	4,966	5,282
	344,438	301,005

Letrat me vlerë të borxhit janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacionet e korporatave	86,263	97,090
Obligacionet qeveritare	243,395	90,493
Letrat komerciale te korporatave	9,814	-
	339,472	187,583

Inestimet në bankat janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Investimet në TEB	-	113,422
	-	113,422

7. LETRAT ME VLERË NË DISPOZICION PËR SHITJE

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Letrat me vlerë të borxhit (obligacione qeveritare)	24,385	24,175
Interesi i përllogaritur	277	277
	24,662	24,452

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

8. PRONA DHE PAJISJET

	Automjetet me lizing financiar	Kompjuterët dhe pajisjet tjera	Gjithsej
Kosto:			
Më 1 janar 2014	-	90,749	90,749
Shtesat	17,500	-	17,500
Më 31 dhjetor 2014	17,500	90,749	108,249
Shtesat	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	17,500	90,749	108,249
Zhvlerësimi i akumuluar:			
Më 1 janar 2014	-	87,081	87,081
Shpenzimi i vitit	3,208	1,856	5,064
Më 31 dhjetor 2014	3,208	88,937	92,145
Shpenzimi i vitit	3,500	1,462	4,962
Më 31 dhjetor 2015	6,708	90,399	97,107
Vlera neto në libra:			
Më 31 dhjetor 2015	10,792	350	11,142
Më 31 dhjetor 2014	14,292	1,812	16,104

Nuk ka artikuj të pronës dhe pajisjeve që janë vendosur si kolateral.

9. PASURITË E PAPERKSHME

	Softveri	Gjithsej
Kosto:		
Me 1 janar 2014	128,753	128,753
Shtesat	-	-
Më 31 dhjetor 2014	128,753	128,753
Shtesat	-	-
Më 31 dhjetor 2015	128,753	128,753
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Me 1 janar 2014	118,553	118,553
Shpenzimi i vitit	4,200	4,200
Më 31 dhjetor 2014	122,753	122,753
Shpenzimi i vitit	4,200	4,200
Më 31 dhjetor 2015	126,953	126,953
Vlera neto në libra:		
Më 31 dhjetor 2015	1,800	1,800
Më 31 dhjetor 2014	6,000	6,000

Fondi Slloveni Kosovari i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

10. PASURITË TJERA

Të arkëtueshmet tjera në pasqyrën e pozitës financiare janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të arkëtueshmet nga F2	15,663	-
Të arkëtueshmet nga tarifa e menaxhmentit	7,195	6,969
Të arkëtueshmet nga tarifa e hyrjes dhe daljes	2,190	1,443
Llogaritë e arkëtueshme	-	303
Parapagimet	508	441
Parapagimi tatimor	27,950	33,659
	53,506	42,816

Tarifa e menaxhmentit është e arkëtueshme nga fondet dhe përmban të arkëtueshmet nga tarifa hyrëse dhe tarifa e menxhamnetit. Tarifat hyrëse ngarkohen për çdo pjesëmarrës të ri në fond me një normë prej 3% të kontributit të paguar.

Tatimi parapaguar përfaqëson tatimin mbi të ardhurat nga interesi në bankat lokale, i cili është mbajtur në burim. Që nga viti Shoqëria ka akumuluar humbje, të cilën ajo mund ta bart përpara për 7 vjet, Shoqëria ka të drejtë të kërkojë përsëri këtë tatim apo zbres atë nga të ardhurat e tatueshme të ardhmen.

11. DETYRIMET TREGTARE DHE TJERA

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorët	5,643	5,147
Detyrimet ndaj të punsuarve	1,428	-
Detyrimet ndaj fondit	4,429	134
Detyrimet për Kontributin pensional dhe Tatimin mbi të ardhurat personale	2,095	814
Detyrime ndaj tatimit në të ardhura	1,727	-
Të tjera	36	36
	15,358	6,131

12. DETYRIMET E LIZINGUT FINANCIAR

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Interesi afatgjatë – mbajtja e lizingut		
<i>Lizingu</i>		
Detyrimi ndaj lizingut afatgjatë	9,476	11,949
Minus: Maturiteti aktual	(2,746)	(2,473)
Mbajtja e interesit afatgjatë për lizing	6,730	9,476
Interesi afatshkurtër – mbajtja e lizingut		
<i>Lizingu</i>		
Maturiteti aktual i lizingut afatgjatë	2,746	2,473
Lizingu afatshkurtër	2,746	2,473
	9,476	11,949

Më 14 janar 2014 Shoqëria ka hyrë në marrëveshje me Factor Leasing për lizing financiar të automjeteve. Lizingu financiar ka maturitet 60 muaj duke mbajtur interesin 10,50% në vit.

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali Aksionar

Më 31 dhjetor 2015, si pas librit të aksionarëve në pasqyrën e pozitës financiare, vlera totale e kapitalit aksionar arrin shumën në 400,000 Euro (31 dhjetor 2014: 400,000 Euro).

Struktura e kapitalit aksionar të Shoqërisë sipas librit të aksionarëve për 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si në vijim:

	2015	2014
Prva Group PLC, Slovenia	67.40%	67.40%
Dukagjini sh.p.k, Republika e Kosoves	32.60%	32.60%
	100.00%	100.00%

Asambleja e Përgjithshme e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2011 ka vendosur të zvogëlojë kapitalin e regjistruar në 3,600,000 Euro. Me këtë vendim, Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të përdor vetëm Licencën për Fondin Suplementar Pensional për Individë dhe të kthejë Licencën e Menaxhimit të Pasurisë.

Prandaj Bordi Ekzekutiv i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës më 12 janar 2012 ka marrë vendim të tërheq licencën për Menaxher Pasurish nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve, dhe të vazhdojë licencën për Fondin Suplementar të Pensioneve Individuale.

Shoqëria është e regjistruar në Agjensionin Kosovar për regjistrim të biznesit të Republikës së Kosovës me numër të dosjës 70378739 të datës 4 shtator 2006. Sipas dosjës së regjistrimit, e cila është e rifreskuar menjëherë pas tërheqjes së kapitalit prej 3,600,000 Euro më 14 korrik 2011, totali i kapitalit aksionar arrin shumën prej 400,000 Euro prej të cilave Prva Pokojninska Druzhba D.D ka paguar 269,600 Euro ose 67.4% dhe Dukagjini Sh.p.k ka paguar 130,400 Euro ose 32.6% nga totali i regjistruar i kapitalit aksionar.

14. TË HYRAT NGA SHITJA E LETRAVE ME VLERË

Të hyrat nga shitja e letrave me vlere jan në vlerë prej 1,823 Euro, nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim per shkak te legjislacioni në fuqi nga 1 dhjetor 2014 në Portugali. Tatimi në të hyrat nga interesi në bazë të legjislacionit në Portugali nga 1 dhjetor 2014 është 35%, prandaj Menaxhmenti i Shoqërisë vendosi të shes këtë leter me vlerë bazuar në IAS 39AG 22.

15. TË HYRAT NGA INTERESI

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat e depozitave të bankave	1,401	7,234
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	12,912	10,002
	14,313	17,236

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

16. SHPENZIMET OPERATIVE

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Pagat dhe shpenzimet e tjera të personelit	51,479	47,873
Shpenzimet për operacionet e biznesit	5,400	15,600
Shërbimet financiare, këshillëdhënëse dhe mirëmbajtja e llogarisë kursimeve	10,265	10,220
Shpenzimet administrative	12,287	11,732
Zhvlerësimi dhe amortizimi (Shënim 8,9)	9,162	9,264
Shpenzime të qirasë	4,800	4,800
Shpenzime të telefonit	2,435	2,417
Shpenzimet e derivateve	2,118	2,303
Shpenzimet e karburantit	1,138	1,259
Tarifat bankare	947	889
Tatimet (interesi, qiraja)	432	432
Marketing dhe reklamat	39	110
Shpenzimet tjera	6,648	6,405
	107,150	113,304

Shpenzimet për operacionet e biznesit janë të lidhura me Shoqërinë mëmë Prva grup për kontrollimin dhe mbështetjen e Shoqërisë për problemet e përditshme.

17. SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIM

Shpenzimet e tatimit mbi fitim në pasqyrën e të ardhurave analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	28,208	11,149
Tatimi në shkallën prej 10% (2014: 10%)	2,821	1,115
Korrigjuar për efekte tatimore në:		
Shpenzimet e pa lejueshme për qëllime tatimore		
Të ardhurat e pa tatueshme për qëllime tatimore		
Artikuj tjerë të tatueshëm - taksat e mbajtjes në		(1,324)
Humbjet tatimore të bartura	(10,934)	(22,427)
Taksat mbi të ardhurat e rikuperueshme		1,324
Tatimi mbi fitimin në normën 10%	1,727	-

Gjatë vitit 2010 aksionerët vendosën që humbja e akumuluar të mbulohet me kapitalin e aksionarëve të tyre. Vlera e financuar nga kapitali aksionar ishte 660,000 Euro. Pas humbjes së akumuluar financimi është zvogëluar në vlerë prej 4,682 Euro, ndërsa për qëllime tatimore humbje të akumuluar ende mund të bartet deri në shtatë vjet, edhe pse ajo ishte e mbuluar nga kapitali aksionar.

Shoqëria nuk i është nënshtruar një kontrolli nga autoritetet lokale tatimore për vitin 2015. Menaxhmenti i Shoqërisë përdor vlerësimin e tij më të mirë dhe gjykimin në përputhje me ligjet tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin në përputhje me kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimi i tatimit deri më 31 dhjetor 2015 mund të ndryshojnë në krahasim me atë të raportuar në pasqyrat financiare.

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

18. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Balancat dhe transaksionet e rëndësishme me palët e lidhura paraqiten si vijon:

31 dhjetor 2015	Prva Group	Fond 1	Fond 2	Personeli drejtues kryesor	Gjithsej
Të arkëtueshmet					
Të arkëtueshmet nga tarifa e menaxhimit	-	7,194	15,662	-	22,856
Të arkëtueshmet nga tarifat hyrëse	-	2,190	-	-	2,190
Gjithsej të arkëtueshmet	-	9,384	15,662	-	25,046
Detyrimet					
Detyrimet	-	1,100	328	-	1,428
Gjithsej detyrimet	-	1,100	328	-	1,428
Neto të arkëtueshmet/detyrimet	-	8,284	15,334	-	23,618
Te hyrat					
Të hyrat nga tarifat hyrëse	-	13,610	-	-	13,610
Të hyrat nga tarifat dalëse	-	4,913	-	-	4,913
Të hyrat nga tarifa e menaxhimit	-	84,998	15,662	-	100,660
Gjithsej të hyrat	-	103,521	15,662	-	119,183
Shpenzimet					
Shpenzimet per operimin e biznesit	5,400	-	-	-	5,400
Shpenzimet per IT	2,400	-	-	-	2,400
Sherbimet e softuerit	4,200	-	-	-	4,200
Pagat dhe shpenzimet tjera	-	-	-	23,707	23,707
Gjithsej shpenzimet	12,000	-	-	23,707	35,707
Neto të hyrat/shpenzimet	(12,000)	103,521	15,662	(23,707)	83,476

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

18. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

31 dhjetor 2014	Prva Group	Fondi 1	Fondi 2	Personeli drejtues kryesor	Gjithsej
Të arkëtueshmet					
Të arkëtueshmet nga tarifa e menaxhimit	-	6,969	-	-	6,969
Të arkëtueshmet nga tarifat hyrëse	-	1,443	-	-	1,443
Gjithsej të arkëtueshmet	-	8,412	-	-	8,412
Detyrimet					
Detyrimet	-	-	134	-	134
Gjithsej detyrimet	-	-	134	-	134
Neto të arkëtueshmet/detyrimet	-	8,412	(134)	-	8,278
Te hyrat					
Të hyrat nga tarifat hyrëse	-	13,344	-	-	13,344
Të hyrat nga tarifat dalëse	-	4,349	-	-	4,349
Të hyrat nga tarifa e menaxhimit	-	79,061	10,463	-	89,524
Gjithsej të hyrat	-	96,754	10,463	-	107,217
Shpenzimet					
Shpenzimet per operimin e biznesit	15,600	-	-	-	15,600
Shpenzimet per IT	2,400	-	-	-	2,400
Sherbimet e softuerit	4,200	-	-	-	4,200
Pagat dhe shpenzimet tjera	-	-	-	21,063	21,063
Gjithsej shpenzimet	22,200	-	-	21,063	43,263
Neto të hyrat/shpenzimet	(22,200)	96,754	10,463	(21,063)	63,954

Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

19. KONTIGJENCAT

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2015 nuk është llogaritur provizion për humbjet e mundshme të ndërlidhura me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Shoqërisë, rregullisht analizon risqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me seancat gjyqësore dhe pretendimet e mundshme me synim kundër Shoqërisë, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultatet e këtyre çështjeve nuk mund të caktohen me saktësi, menaxhmenti i Shoqërisë beson se nuk ka gjasa që të rezultojnë detyrime materiale.

Zotimet operative të qirasë

Më 31 dhjetor 2015 është një marrëveshje e qirasë për objekte biznesore për periudha kohore të padefinuara, pagesa mujore neto është 400 Euro.

20. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas 31 dhjetor 2015 - datën e raportimit, deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për zbulimin e këtyre pasqyrave financiare.